



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 104/02-23594 /17

Kaçanik, 11.07 /2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe kërkesës Nr. 104/02-23594, të N.P X-Plast, Kryetari i Komunës merr këtë :

### V E N D I M

Për shkëputjen e kontratës për shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale  
( parcelës Nr. 5-0 në zonën kadastrale Kaçanik-Kovaçec)

1. Aprovohet kërkesa e Kompanisë N.P X-.Plast për shkëputjen e kontratës Nr. 01/104/02-10029/2017 për shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të lidhur më 28.03.2017 në mes të Kryetarit të komunës z. Besim Ilazi dhe pronarit të kompanisë në fjalë z.Nexhat Vogliqi.
2. Sipas këtij vendimi Kompania N.P. X-Plast, nuk ka kurrëfarë të drejta dhe detyrime lidhur me shfrytëzimin e tokës- parcelës Nr. 5-0 në zonën kadastrale Kaçanik-Kovaçec .
3. Obligohet Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë dhe Drejtoria për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit të bëjë ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Të njoftohen:

- z. Nexhat Vogliqi-pronar i N.P X-Plast
- DBZHRR dhe DUKMM
- Arkiva e komunës



Kryetari i Komunës  
Besim Ilazi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

Dt. 19.07.2018  
Nr. 01-104/02-23250/18

#### Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit të Buxhetit Nr. 06/L-020 per vitin 2018 si dhe të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kërkesës së ish-Ushtarëve të njësitit të Tropojës me nr. 01-104/02-23234/18 e dt. 19.07.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

### VENDIM

#### Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohet ish-Ushtarëve të njësitit të Tropojës , që të furnizohen me derivate- naftë në vlerë deri 400 euro, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara - të specifikuara sipas kërkesës së bashkëngjitur të këtij vendimi.

#### Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi, këshilli organizativ i ish-Ushtarëve të njësitit të Tropojës, mund të furnizohet me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate “Bubeari Petrol” dhe pas furnizimit , obligohet që fletdërgesat në ngarkim ti dorëzoj pranë të Drejtorisë së Administratës Komunale ( Zyra e Pranimi të mallrave - faturave) –Kaçanik.

#### Neni 3.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, dhe

#### **Bashkëngjitur këtij vendimi:**

- Kërkesa e Këshillit Organizativ (ish-Ushtarëve të njësitit të Tropojës).



Besim Hazi, Kryetar i komunës